



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç “ të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme mbajtur më 12.09.2011, mori këtë:

**V E N D I M**

Për transferimin e mjeteve buxhetore të komunës

**Neni 1**

Mjetet e lira në programin (18024) Drejtoria për Shërbime Publike, projekti “ndërtimi i urës mbi lumin Sitnicë” , kodi i projektit 83449, fondi burimor (10) të bëhet transferi i mjeteve në shumën prej 24.881.86 €, në programin (47024) Drejtoria për Bujqësi, Ekonomi dhe Zhvillim Rural, në projektin “ndërtimi, asfaltimi i rrugëve me infrastrukturë përcjellëse” , kodi 83132.

**Neni 2**

Mjetet e lira në programin (16324) Drejtoria për Administratë dhe Personel, projekti (furnizimi me kamera të komunës), kodi i projektit 83120, fondi burimor (21) të bëhet transferi i mjeteve në shumën prej 4.314.42 € në programin (47024) Drejtoria për Bujqësi, Ekonomi dhe Zhvillim Rural, në projektin “ndërtimi, asfaltimi i rrugëve me infrastrukturë përcjellëse” , kodi 83132.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Prokurim Publik.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit  
Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç “ të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme mbajtur më 12.09.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës

Neni 1

Mjetet e lira në programin (18024) Drejtoria për Shërbime Publike, projekti “ndërtimi i urës mbi lumin Sitnicë” , kodi i projektit 83449, fondi burimor (10) të bëhet ridestinimi i mjeteve në shumën prej 40.835.50 €, për realizimin e projektit të ri “rregullimi i infrastrukturës në rr. Hamit Hyseni”.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Prokurim Publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

---

Bazuar në nenin 40.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.3 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme mbajtur më 12.09.2011, mori këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës ia delegon përgjegjësitë kryetarit të Komunës për marrje të vendimeve për ridestinim, përkatësisht shfrytëzim të mjeteve të lira të mbetura nga projektet e realizuara, në projekte tjera të planifikuara me vendim të kuvendit të komunës për vitin 2011.

**Neni 2**

Kuvendi i komunës mund ta tërheqë delegimin në çdo kohë.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: kryetari i komunës dhe drejtoritë komunale kompetente në Vushtrri.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

---

Bazuar në nenin 11, 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 30 dhe 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, pas shqyrtimit të peticioneve të fshatrave: Studime e Epërme, Beçuk dhe Karaçë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme mbajtur më 12.09.2011, mori këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

Aprovohen peticionet e fshatrave: Studime e Epërme, Beçuk dhe Karaçë për anulimin e vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.161/11, dt. 28.07.2011.

**Neni 2**

Obligohet Drejtoria për Arsim në Vushtri që të rikthen nxënësit e fshatrave të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, nga shkollat amë në paralelet e ndara të shkollave, në të cilat është zhvilluar procesi mësimor më parë.

**Neni 3**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e jashtëzakonshme mbajtur më 12.09.2011, mori këtë:

**V E N D I M**

**Për ridestinimin e mjeteve buxhetore të komunës**

**Neni 1**

Nga projekti kapital “ndërtimi, asfaltimi i rrugëve me infrastrukturë përcjellëse” kodi i projektit 83132, programi 470 (bujqësi dhe pylltari), mjetet e lira 23.200 € nga fondi burimor 21 të ridestinohen në projektin kapital të ri “krijimi i hapësirave të gjelbërta dhe këndit të lojërave në Parkun e Qytetit”, në drejtorinë e njëjtë, në shumën prej 23.200 €.

**Neni 2**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Prokurim Publik.

**Neni 3**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**